



Republika e Kosovës Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucion i Avokatit të Popullit Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution
Nr./Br./No. <u>69812022</u>
Nr.i fq/Br.str./Nr.pg. <u>27104122</u>
Date/Datum/Date:



PRISHTINA PRISTINA PRISTINA  
Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucion i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT  
I  
AVOKATIT TË POPULLIT

Ex-officio nr.411/2021

në lidhje me themelimin e ekpit profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore përfëmijët me aftësi të kufizuara

Drejtuar:

- Abdulhadi Krasniq, kryetar, komuna e Mamushës
- Imri Ahmeti, kryetar, komuna e Lipjanit
- Ilir Ferati, kryetar, komuna e Istogut
- Bashkim Ramosaj, kryetar, komuna e Deçanit
- Fadil Nura, kryetar, komuna e Skenderajt
- Kadri Rahimaj, kryetar, komuna e Kamenicës
- Qemajl Aliu, kryetar, komuna e Shtimes
- Smajl Latifi, kryetar, komuna e Rahovecit
- Dragisa Miloviq, kryetar, komuna e Zveçanit
- Srdjan Vuloviq, kryetar, komuna e Zubin Potokut
- Dalibor Jevtiq, kryetar, komuna e Shtërpçës
- Zoran Todiq, kryetar, komuna e Leposaviqit
- Katarina Ristiq - Iliq, kryetare, komuna e Ranillugut
- Dragan Petkoviq, kryetar, komuna e Parteshit
- Milan Radojeviq, kryetar, komuna e Mitrovicës Veriore
- Vladan Bogdanoviq, kryetar, komuna e Kllokotit
- Ljiljana Subariq, kryetare, komuna e Graçanicës

Prishtinë, më 27 prill 2022

## Qëllimi i raportit

1. Ky Raport me rekomandime (në tekstin e mëtejmë: Raporti) ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes së institucioneve shtetërore dhe dhënien e rekomandimeve përkatëse pë trajtimin dhe ndërmarrjen e masave në kuadër të kompetencave dhe të përgjegjësive ligjore lidhur me themelimin e ekspert profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore përfmijët me aftësi të kufizuara.

## Baza ligjore

2. Avokati i Popullit, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës<sup>1</sup> (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr.16/, 26 qershor 2015<sup>2</sup>, Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Ligi për Avokatin e Popullit), pos të tjera, i ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
  - 2.1. Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoritetave publike (neni 132, paragrafi 1, i Kushtetutës);
  - 2.2. Avokati i Popullit mund të japë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore (neni 135, paragrafi 3, i Kushtetutës);
  - 2.3. të térheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tillë dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoritetave përkatëse në lidhje me rastet e tillë (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, i Ligjit për Avokatin e Popullit);
  - 2.4. të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, i Ligjit për Avokatin e Popullit);
  - 2.5. t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, i Ligjit për Avokatin e Popullit).

## Faktet dhe dispozitat e zbatueshme lidhur me çështjen

3. Ligji nr. 04/l-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (në tekstin e mëtejme: LAPRK) ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës (GZRK) me 16 shtator 2011<sup>3</sup>. LAPRK-ja rregullon edukimin, arsimin dhe aftësimin parauniversitar nga niveli 0 deri në 4 i ISCED-it<sup>4</sup>, duke përfshirë arsimin dhe aftësimin e fëmijëve dhe të të rriturve që marrin kualifikime në këto nivele.
4. Neni 41 i LAPRK-së (Vlerësimi profesional) përcakton:

*“1. Çdo komunë duhet që vetë apo në bashkëpunim me komunat e tjera të themelojë ekip profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore, të përbërë nga specialistë të arsimit, punës sociale, psikologjisë dhe të rehabilitimit, si mbështetje e*

<sup>1</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

<sup>2</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10922>

<sup>3</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770>

<sup>4</sup> LAPR, nen 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.21.

*jashtme për institucionet arsimore dhe aftësuese për të ofruar këshillime dhe udhëzime për mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit.*

*2. Procedura e vlerësimit nga ekipi profesional mund të fillohet me kërkesën e ndonjë prindi apo institucioni arsimor a aftësues me pëlqimin e prindit.*

*3. Në përpjthje me parimet e arsimit gjithëpërfshirës dhe duke pasur parasysh dëshirat dhe opinionet e prindërvë, vlerësimi profesional shqyrton dhe përcakton nëse nxënësi ka nevojë për vijimin e shkollimit special dhe çfarë lloji i mësimdhënies duhet të ofrohet, ku qëllimet e vlerësimit janë si në vijim:*

*3.1. për të vlerësuar aftësitë, interesimet dhe nevojat e fëmijës;*

*3.2. për të dhënë rekomandime mbi metodat e mësimdhënies, mjetet e mësimdhënies dhe mbi përshtatjet e tjera të nevojshme për mësimnxëniet dhe mirëgenien e fëmijës;*

*3.3. për të përkufizuar nevojat për pajisjet të posaçme që nevojiten në mësimdhëniet;*

*3.4. për të dhënë rekomandime për regjistrimin e nxënësit.*

*4. Ministria, me akt nënligjor, përcakton procedurat dhe afatet kohore për vlerësimin profesional.*

*5. Nëse vendimi i komunës ndryshon nga vlerësimi profesional i ekspertëve, arsyet për vendimin e komunës duhet të shpjegohen me shkrim. Prindërvë u jepet mundësia të bëjnë ankesë me shkrim. Në raste të tillë, Ministria do të sjellë vendimin përfundimtar dhe ajo mund të konsultohet me këta ekspertë siç përcakton vet.*

*6. Përbajtja e mësimdhënies për nxënësit me nevoja të veçanta për arsim përcaktohet në planet e arsimit individual. Procedura dhe modeli i këtyre planeve rregullohet me akt nënligjor.”*

*5. Më 12 korrik 2021, Avokati i Popullit ka iniciuar hetime me veticinitativë (*ex-officio*) duke u bazuar në nenin 16, parografi 4, të Ligjit për Avokatin e Popullit<sup>5</sup>, lidhur me themelimin e këtyre ekipeve profesionale në komunat e Republikës së Kosovës.*

### **Veprimet e Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP)**

*6. Gjatë muajit gusht 2021, Avokati i Popullit, përmes shkresës, ka kërkuar informata nga komunat e Kosovës<sup>6</sup> lidhur me veprimet që janë ndërmarrë apo që priten të ndërmerrin në kuadër të kompetencave dhe të përgjegjësive ligjore për themelimin e ekipit profesional vlerësues dhe përkrahës par nevojat e posaçme arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuara, në pajtim me nenin 41 të LAPRK-së.*

*7. Gjatë muajve shtator dhe tetor 2021, IAP-ja ka marrë përgjigje nga këto komuna:*

<sup>5</sup> “Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t’iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (*ex officio*), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtresë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazuë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe lirite e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.”

<sup>6</sup> Komunat: Prishtinë, Podujevë, Fushë Kosovë, Mitrovicë e Jugut, Mamushë, Malishevë, Lipjan, Klinë, Istog, Glogoc, Gjakovë, Junik, Dragash, Deçan, Ferizaj, Skenderaj, Pejë, Kamenicë, Kaçanik, Hani i Elezit, Gjilan, Vushtrri, Viti, Suharekë, Shtime, Rahovec, Prizren, Obiliq, Zveçan, Zubin Potok, Shtërpcë, Novobërdë, Leposaviq, Ranillug, Partesh, Mitrovicë Veriore, Kllokot, Graçanicë.

Prishtinë, Mitrovicë e Jugut, Malishevë, Klinë, Gllogoc, Gjakovë, Junik, Dragash, Pejë, Kaçanik, Han i Elezit, Gjilan, Vushtrri, Viti, Suharekë, Rahovec, Prizren, Obiliq, Zveçan, Zubin Potok, Shtërpçë dhe Kllokot, për informatat e kërkuar lidhur me çështjen.

8. Meqenëse jo të gjitha komunat iu kanë përgjigjur kërkësës, në tetor 2021 Avokati i Popullit iu ka dërguar letër përsëritëse komunave të mbetur<sup>7</sup>, duke ua rikujtuar nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës dhe nenet 18 dhe 25 të Ligjit për Avokatin e Popullit, që u bëjnë thirrje autoriteteve publike t'u përgjigjen kërkësave të IAP-së për sigurimin e informacioneve, dokumenteve dhe dosjeve brenda kohës së arsyeshme.
9. Gjatë muajve tetor dhe nëntor 2021, IAP-ja ka marrë përgjigje nga këto komuna: Podujevë, Ferizaj, Ranillug, Fushë Kosovë, Novobërdë dhe Lipjan.
10. Avokati i Popullit, deri në publikimin e këtij Raporti, nuk mori përgjigje nga komunat: Mamushë, Istog, Deçan, Skenderaj, Kamenicë, Shtime, Leposaviq, Partesh, Mitrovicë Veriore dhe Graçanicë. Në këtë rast këto komuna kanë dështuar të përgjigjeshin në kërkësat e Avokatit të Popullit duke shkelur dispozitat përkatëse kushtetuese dhe të Ligjit për Avokatin e Popullit. Sidoqoftë, kjo nuk e pengon Avokatin e Popullit që t'i japë konkluzionet dhe rekomandimet lidhur me çështjen.<sup>8</sup>

### Instrumentet ligjore dhe analiza e çështjes

11. Kushtetuta mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut duke përfshirë këtu edhe të drejtat e fëmijës. Zbatimi dhe realizimi në praktikë i këtyre të drejtave është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës. Kushtetuta shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha institucioneve që t'i respektojnë liritë dhe të drejtat e njeriut<sup>9</sup>, dhe ky parim vlen për të gjithë, përfshirë edhe institucionet përkatëse komunale, duke zbatuar parimin e arsimit gjithëpërfshirës<sup>10</sup>, si një parakusht themelor për realizimin e së drejtës së fëmijëve për arsim në pajtim me dispozitat ligjore dhe me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.
12. Kushtetuta obligon institucionet që të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, t'i marrin në interesin më të mirë të fëmijëve, si dhe garanton arsimimin si e drejtë e përgjithshme e njeriut që e gjithë person<sup>11</sup>. Marrë parasysh rëndësinë e së drejtës për arsim, ajo fillimisht ishte shpallur për herë të parë në vitin 1948 përmes Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut<sup>12</sup>, më vonë e konkretizuar në Konventën për të Drejtat e Fëmijës.<sup>13</sup> Këto instrumente ndërkombëtare deklarojnë që të paktën arsimi fillor është falas dhe i detyrueshëm, ndërsa arsimi i mesëm dhe i lartë do të bëhen në mënyrë progresive të arritshme për të gjithë, edhe pse jo domosdoshmërisht falas. Pra, edukimi

<sup>7</sup> Komunat: Podujevë, Fushë Kosovë, Mamushë, Lipjan, Istog, Deçan, Ferizaj, Skenderaj, Kamenicë, Shtime, Novobërdë, Leposaviq, Ranillug, Partesh, Mitrovicë Veriore, Graçanicë.

<sup>8</sup> Neni 24, paragrafi 4, i Ligjit për Avokatin e Popullit.

<sup>9</sup> Kushtetuta, neni 21.

<sup>10</sup> LAPRK, neni 40, paragrafi 2.

<sup>11</sup> Kushtetuta, neni 50(4) dhe 47 (1)

<sup>12</sup> E drejta për edukim garantohet me nenin 26 të DUDNj-së.

<sup>13</sup> Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Konventa për të Drejtat e Fëmijës, 1989, në nenet 28 dhe 29, në: [https://www.unicef.org/tfymacedonia/CRC\\_albanian\\_language\\_version\(3\).pdf](https://www.unicef.org/tfymacedonia/CRC_albanian_language_version(3).pdf) Konventa është drejtpërdrejt e zbatueshme në Kosovë dhe ka përparësi zbatimi krasuar me aktet e tjera ligjore vendore në bazë të nenit 22 të Kushtetutës.

është parë si faktor kryesor i zhvillimit të qëndrueshëm të njeriut, përmes të cilit rritet përmirësimi i cilësisë së jetës në nivel individual, familjar, shoqëror dhe global.

13. Konsideratë mbizotëruese interesit më të mirë të fëmijës<sup>14</sup> i jep edhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës (në tekstin e mëtejmë: Konventa)<sup>15</sup>, e cila sipas Kushtetutës është drejtpërdrejt e zbatueshme në Kosovë. Prandaj çdo veprim i organeve shtetërore duhet të jetë në pajtim të plotë me qëllimin e Konventës. Shkelja eventuale e dispozitave të kësaj Konvente paraqet shkelje të Kushtetutës. Komiteti i Konventës ka identifikuar interesin më të mirë të fëmijës si një nga katër parimet e përgjithshme të Konventës për interpretimin e saj dhe duke e zbatuar atë në raport me të gjitha të drejtat e tjera të fëmijës<sup>16</sup>. Ajo është një koncept dinamik që kërkon një vlerësim të përshtatshëm për çdo rast specifik. Ky parim është i mishëruar edhe në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës (LMF).<sup>17</sup> Në rastin konkret, e drejta për arsim për fëmijët me aftësi të kufizuara interpretohet në interesin më të mirë të tyre për t'ua mundësuar atyre qasjen sa më të lehtë dhe efektive në realizimin e kësaj të drejtë.
14. Më tutje, nen 28 i Konventës rekomandon ushtrimin e së drejtës së arsimit “*në mënyrë progresive dhe mbi bazën e mundësive të barabarta*”. E drejta për arsimim mund të karakterizohet si një “*e drejtë e aftësimit-fuqizimit*”. Një e drejtë e tillë i ofron individit më shumë kontroll për drejtimin e jetës së tij apo saj, në veçanti kontrollin mbi veprimet e shtetit kundrejt individit. Me fjalë të tjera, ushtrimi i së drejtës së arsimimit i ndihmon fëmijët në zhvillimin e plotë të personalitetit, talenteve dhe aftësive të tij mendore e fizike<sup>18</sup>, në mënyrë që t'i përjetojë të mirat e të drejtave të tjera. Konventa njeh nevojat e veçanta të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe parashevë që ndihma e dhënë nga shteti duhet të jepet falas sa herë që të jetë e mundur që fëmijëve me aftësi të kufizuara t'u mundësohet të marrin arsimim në mënyrë efektive, kualifikim, shërbime shëndetësore, shërbime riaftësimi, përgatitje për punësim dhe veprimitari argëtuese, në mënyrë që ata të sigurojë një integrim shoqëror dhe zhvillim individual sa më të plotë, përfshirë zhvillimin e tyre kulturor dhe shpirtëror.<sup>19</sup>
15. LAPRK-ja obligon institucionet e përfshira në ofrimin e arsimit parauniversitar, siç është rregulluar përmes këtij ligji dhe ligjeve të tjera, që të planifikojnë dhe ofrojnë shërbime efikase, efektive, fleksibile, **gjithëpërfshirëse** dhe profesionale, të dizajnuara për t'u ofruar të **gjithë fëmijëve të drejtat e barabarta për shkollim**, në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike, si dhe për ta avancuar zhvillimin e tyre arsimor e social.<sup>20</sup> Moszbatimi i duhur i kësaj dispozite kontribuon që fëmijët me aftësi të kufizuara të vazhdojnë të përjetojnë vështirësi serioze dhe të përballen me pengesa për gëzimin e plotë të të drejtave të përcaktuara me ligj, përfshirë këtu edhe të drejtën për arsimim gjithëpërfshirës.

<sup>14</sup> Konventa, nen 3.

<sup>15</sup> Në pajtim me nenin 22 të Kushtetutës, Konventa zbatohet drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe ka prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave, ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

<sup>16</sup> Komiteti i Konventës, Komenti i përgjithshëm Nr.5, në:

[https://tbinternet.ohchr.org/\\_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRC%2fGC%2f2003%2f5&Lang=en](https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRC%2fGC%2f2003%2f5&Lang=en).

<sup>17</sup> Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës, nen 5.

<sup>18</sup> Konventa, nen 29.

<sup>19</sup> Konventa, nen 23.

<sup>20</sup> LAPRK, nen 3, paragrafi 3.

16. LAPRK-ja obligon komunat që t'i regjistrojë nxënësit me vështirësi në të nxënë apo me aftësi të kufizuara dhe më pas të veprojnë sipas procedurave të parapara në nenin 41 të këtij ligji lidhur me vlerësimin profesional të tyre. Në fryshtë e kësaj, ky ligj obligon komunat që vetë apo në bashkëpunim me komunat e tjera të themelojnë ekip profesional vlerësues dhe përkrahës. Ky ekip duhet të jetë i veçantë për nevojat e posaçme arsimore të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe të përbëhet nga specialistë të arsimit, punës sociale, psikologjisë dhe të rehabilitimit, si mbështetje e jashtme për institucionet arsimore dhe aftësuese për të ofruar këshillime dhe udhëzime për mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit. Për më tepër, ky ligj parashev procedurën e vlerësimit nga ekipi profesional si dhe qëllimet e vlerësimit të nxënësit me aftësi të kufizuar.<sup>21</sup>
17. Gjithëpërfshirja është një parakusht themelor për realizimin e së drejtës së fëmijëve për arsimim sipas Konventës dhe detyrimit për arsim fillor për të gjithë në kushte të barabarta, të garantuara me Kushtetutë. Në ketë drejtim, LAPRK-ja ka përcaktuar edhe autorizimet që dalin nga parimi i arsimit gjithëpërfshirës, i përcaktuar në nenin 40, parografi 2: “*2. Parimi i arsimit gjithëpërfshirës nënkuption se: 2.1. institucionet arsimore dhe aftësuese duhet të akomodojnë të gjithë fëmijët, pa dallim të kushteve të tyre fizike, intelektuale, sociale, gjuhësore apo të tjera dhe duhet të promovojë integrimin dhe kontaktin mes fëmijëve; 2.2. mbështetja përkatëse duhet të ofrohet bazuar në nevojat intelektuale të nxënësve; dhe 2.3. ambientet e posaçme arsimore apo shkollat speciale arsyetohen vetëm pasi që nga vlerësimi i ekspertit del se nuk është praktike të regjistrohet ndonjë fëmijë në shkollën e rregullt publike apo në institucionin e aftësimit.*”
18. Me qëllimi të zbatimit të LAPRK-së, Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, më 22 dhjetor 2017 ka nxjerrë Udhëzim Administrativ NR.16/2017 - Vlerësimi Pedagogjik i Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore (në tekstin e mëtejmë: Udhëzimi). Ky Udhëzim i referohet të gjitha komunave për themelin e ekipave vlerësuese komunale të cilat do të bëjnë vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me aftësi të kufizuara me qëllim që t'u ofrohet arsimim dhe mësimdhënie në përputhje me nevojat dhe potencialet e tyre. Më tutje Udhëzimi përcakton procedurat dhe kompetencat e ekipit vlerësues komunal për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me aftësi të kufizuara.<sup>22</sup>
19. Për më tepër, Ligji nr. 06/l-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr.14/17, korrik 2019, Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: LMF)<sup>23</sup>, në nenin 1 ka përcaktuar qëllimin e tij: “*(...) 1.2. të mbrojë fëmijën nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, abuzimit, keqpërdorimit, shfrytëzimit, neglizhimit apo ndonjë forme tjeter që vë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës; 1.3. të garantojë dhe sigurojë përgjegjësitë e prindërve, familjes, organit të kujdestarisë, shoqërisë dhe të shtetit në kujdesin, mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijës bazuar në interesin*

<sup>21</sup> LAPRK, nen 41, nënparagrafët: 3.1. për të vlerësuar aftësitë, interesimet dhe nevojat e fëmijës; 3.2. për të dhënë rekomandime mbi metodat e mësimdhënieς, mjetet e mësimdhënieς dhe mbi përshtatjet e tjera të nevojshme për mësimnxëniet dhe mirëqenien e fëmijës; 3.3. për të përkufizuar nevojat për pajisjet të posaçme që nevojiten në mësimdhënie; 3.4. për të dhënë rekomandime për regjistrimin e nxënësitet.

<sup>22</sup> Udhëzimi Administrativ, nen 4, parografi 3 : “*Ekipi i vlerësimit ka kompetencë: 3.1. Të bëj vlerësimin pedagogjik për pjesëmarrjen dhe performancën e fëmijës në procesin arsimor bazuar në nevojat individuale të fëmijëve; 3.2. Të përcaktoj institucionin arsimor në të cilin fëmija do të vijoj edukimin dhe arsimimin; 3.3. Përcaktoj llojin e mësimdhënieς; 3.4. Shërbimet e mbështetjes; 3.5. Pajisjet dhe instrumentet e nevojshme ndihmës; 3.6. Shërbimet rehabilituese; 3.7. Transportin e përshtatshëm.”*

<sup>23</sup> [gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20844](http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20844)

*më të mirë të fëmijës; (...).*<sup>24</sup> Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës është ligji i parë në Kosovë që në mënyrë specifike adreson të drejtat e fëmijës duke përfshirë edhe dispozita të veçanta që adresojnë mbrojtjen e fëmijës me aftësi të kufizuara. Neni 46 parasheh: “*Fëmijës me aftësi të kufizuara mund t’i ofrohet shërbimi edukativ, [...] në përputhje me nevojat specifike, në një komunë tjetër nga ajo ku jeton dhe që përmbush kriteret për këtë qëllim.*”<sup>25</sup>

20. Rrjedhimisht, në pajtim me LMF-në, LAPRK-në, Konventën si dhe Kushtetutën, themelimi i ekipit profesional të vlerësimit paraqet një hap të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për realizimin e të drejtës për arsimim të fëmijëve me aftësi të kufizuara si dhe respektimin e parimit të arsimit gjithëpërfshirës.

#### Konstatimet

21. Pas rishikimit të legjislacionit përkatës, të instrumenteve ndërkombëtare, të dokumentacionit të çështjes, të informatave dhe të dhënave që IAP-ja i ka, del se në rastin konkret *ka pasur shkelje të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut*, përkatësisht të të drejtave të fëmijëve, pasi autoritetet përkatëse nuk i kanë përmbushur detyrimet kushtetuese dhe ligjore e as standardec ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Kosovës në lidhje me **themelimin e ekipit profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuara**.
22. Avokati i Popullit, në bazë të dokumentacionit që ka pranuar nga komunat, përkatësisht vendimet për themelimin e ekipit profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuara.
23. Avokati i Popullit, në bazë të autorizimeve ligjore, dokumentacionit të pranuar si dhe mosofrimit të dëshmive, përkatësisht të vendimit për themelimin ekipit profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuara nga disa komuna, konstaton se komunat: Mamushë, Lipjan, Istog, Deçan, Skenderaj, Kamenicë, Shtime, Rahovec, Zveçan, Zubin Potok, Shtërpcë, Leposaviq, Ranillug, Partesh, Mitrovicë Veriore, Kllokot, Graçanicë nuk i kanë themeluar ekipet profesionale vlerësuese dhe përkrahëse për nevojat e posaçme arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuara, siç kërkohet me LAPRK-në dhe me Udhëzim.
24. Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “*Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.*” Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2, të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit: “*(...) ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla (...).*”

Prandaj Avokati i Popullit i

#### REKOMANDON

<sup>24</sup> Për më shumë lidhur me edukimin dhe arsimimin, shih nenin 37 të LMF-së.

<sup>25</sup> Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës, neni 46.

### **Komunës së Mamushës:**

- Ta themelojë ekipin profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore përfëmijët me aftësi të kufizuara, sipas nenit 41 të LAPRK-së.

### **Komunës së Lipjanit:**

- Ta themelojë ekipin profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore përfëmijët me aftësi të kufizuara, sipas nenit 41 të LAPRK-së.

### **Komunës së Istogut:**

- Ta themelojë ekipin profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore përfëmijët me aftësi të kufizuara, sipas nenit 41 të LAPRK-së.

### **Komunës së Deçanit:**

- Ta themelojë ekipin profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore përfëmijët me aftësi të kufizuara, sipas nenit 41 të LAPRK-së.

### **Komunës së Skenderajt:**

- Ta themelojë ekipin profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore përfëmijët me aftësi të kufizuara, sipas nenit 41 të LAPRK-së.

### **Komunës së Kamenicës:**

- Ta themelojë ekipin profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore përfëmijët me aftësi të kufizuara, sipas nenit 41 të LAPRK-së.

### **Komunës së Shtimes:**

- Ta themelojë ekipin profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore përfëmijët me aftësi të kufizuara, sipas nenit 41 të LAPRK-së.

### **Komunës së Rahovecit:**

- Ta themelojë ekipin profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore përfëmijët me aftësi të kufizuara, sipas nenit 41 të LAPRK-së.

### **Komunës së Zveçanit:**

- Ta themelojë ekipin profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore përfëmijët me aftësi të kufizuara, sipas nenit 41 të LAPRK-së.

### **Komunës së Zubin Potokut:**

- Ta themelojë ekipin profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore përfëmijët me aftësi të kufizuara, sipas nenit 41 të LAPRK-së.

### **Komunës së Shtërpçës:**

- Ta themelojë ekipin profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore përfëmijët me aftësi të kufizuara, sipas nenit 41 të LAPRK-së.

### **Komunës së Leposaviqit:**

- Ta themelojë ekipin profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore përfëmijët me aftësi të kufizuara, sipas nenit 41 të LAPRK-së.

### **Komunës së Ranillugut:**

- Ta themelojë ekipin profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme

arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuara, sipas nenit 41 të LAPRK-së.

#### Komunës së Parteshit:

- Ta themelojë ekipin profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuara, sipas nenit 41 të LAPRK-së.

#### Komunës së Mitrovicës Veriore:

- Ta themelojë ekipin profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuara, sipas nenit 41 të LAPRK-së.


#### Komunës së Kllokotit:

- Ta themelojë ekipin profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuara, sipas nenit 41 të LAPRK-së.

#### Komunës së Graçanicës:

- Ta themelojë ekipin profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuara, sipas nenit 41 të LAPRK-së.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Cdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim ne Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkeseve të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqes atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligj*”) dhe në pajtim me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritete, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkësë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*”), ju lutemi mirësish të na informoni për veprimet që do t'i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

  
Me nderime,  
Naim Qelaj  
Avokat i Popullit